



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



SEKTORI I BURIMEVE NJERZORE

Dt. 25.08.2016

NJOFTIM

Më 25 Korrik, Komuna e Prishtinës ka shpallur konkurs për rekrutim të personelit arsimor. Në kuadër të këtij konkursi, ndër të tjerë, janë shpallur vende të lira edhe këto pozita:

- Mësimdhënës për edukatë fizike, SHFMU;
- Mësimdhënës për psikologji, SHML;
- Mësimdhënës për mësim klasor.

Pas shqyrtimi të aplikacioneve, Komisionet përzgjedhëse, në përputhje me kriteret dhe kushtet e shpallura në konkurs, kanë publikuar listën e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet për intervistë me gojë.

Në listat e publikuara, kandidatët **Alban Berisha** (edukatë fizike), **Labinot Dervishaj** (psikologji) dhe **Fitore Berisha** (mësim klasor), kanë vërejtur se emrat e tyre nuk janë përfshi në listat e kandidatëve që janë ftuar për intervistë edhe pse kanë pretenduar që i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me konkurs.

Komisionet përzgjedhëse, me kërkesë të kandidatëve kanë rishqyrtuar aplikacionet dhe kanë konstatuar se pretendimet e tyre janë të sakta dhe kanë vendos që të përshihen në listën e kandidatëve që janë ftuar në intervistë me gojë.



Avni Zuka

Menaxher i Burimeve Njerëzore